LIGJ
Nr.9771, datë 12.7.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR KONTRIBUTET NDAJ SISTEMIT TË MASAVE MBËSHTETËSE PARAPRAKE TË KOMBEVE TË BASHKUARA"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, për kontributet ndaj sistemit të masave mbështetëse paraprake të Kombeve të Bashkuara".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5407, datë 19.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME KONTRIBUTET NDAJ SISTEMIT TË RREGULLIMEVE TË MBËSHTETJES SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Nënshkruesit e Memorandumit të tanishëm, Sh.Tij.z.Besnik Mustafaj, Ministër i Punëve të Jashtme, në përfaqësim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dr.Asha-Rose Migiro, Nënsekretar i Përgjithshëm, në përfaqësim të Kombeve të Bashkuara,

duke njohur nevojën për përshpejtimin e sigurimit të disa burimeve për Kombet e Bashkuara, me qëllim që të zbatojnë efektivisht në kohën e duhur mandatin e fushatave paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara të autorizuara nga Këshilli i Sigurimit;

duke njohur më tej se përparësitë e angazhimit të burimeve për kontributet ndaj operacioneve paqeruajtëse kontribuojnë në rritjen e fleskibilitetit dhe uljen e shpenzimeve,

kanë arritur mirëkuptim për sa vijon:

I. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi mirëkuptimi është identifikimi i burimeve, të cilat Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka treguar se do t'i japë Kombeve të Bashkuara për përdorim në operacione paqeruajtëse, sipas kushteve të përcaktuara.

II. Përshkrimi i burimeve

1. Përshkrimi i hollësishëm i burimeve që do të sigurohen nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përcaktohet në shtojcën ndaj këtij Memorandumi.

2. Në përgatitjen e shtojcës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kombet e Bashkuara kanë ndjekur udhëzimet për sigurimin e burimeve për operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara.

III. Kushti i sigurimit

Vendimi përfundimtar nëse do të kalohen burimet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mbetet një vendim me karakter kombëtar.

IV. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas njoftimit nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mbi përfundimin e procedurave të brendshme shqiptare të kërkuara për hyrjen e tij në fuqi.

V. Ndryshime

Ky Memorandum mirëkuptimi, përfshirë edhe shtojcën, mund të ndryshohet në çdo kohë nga Palët ndërmjet shkëmbimit të letrave.

VI. Përfundimi

Memorandumi i mirëkuptimit mund të përfundohet në çdo kohë nga secila Palë, duke iu nënshtruar një periudhe njoftimi jo më pak se tre muaj ndaj Palës tjetër.

Nënshkruar në Nju Jork më

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Për Kombet e Bashkuara
Sh.Tij.Z.Besnik Mustafaj	Dr.Asha-Rose Migiro
Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë	Nënsekretar i Përgjithshëm

SHTOJCË NDAJ MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME KONTRIBUTET NDAJ SISTEMIT TË MASAVE MBËSHTETËSE PARAPRAKE TË KOMBEVE TË BASHKUARA

PËRMBLEDHJE E KONTRIBUTEVE

Numri në nivel kombëtar	Përshkrimi	Kategoria	Burimi	Përgjigja në kohë	Trupat	Vërejtjet
1.	Kompani e motorizuar këmbësorie	Personel në grup	Ushtria	60 ditë	103	Plotësisht e pajisur
2.	Oficerë personeli	Individë	Ushtria	30 ditë	5	Plotësisht të pajisur
3.	Vëzhgues ushtarakë	Individë	Ushtria	30 ditë	5	Plotësisht të pajisur
4.	Forca policore terreni për shpëtim dhe veprimtari të tjera operacionale	Individë	Policia	30 ditë	50	Plotësisht të pajisur
5.	Forca policore në terren për patrullim	Personel në grup	Policia	30 ditë	50	Plotësisht të pajisur
6.	Ekspertë të policisë për hetime krimesh	Individë/personel në grup	Policia	30 ditë	20	Plotësisht të pajisur
7.	Ekspertë trajnimi (patrullime, kontroll kufiri, luftë ndaj trafiqeve të paligjshme etj.)	Individë	Policia	30 ditë	10	Plotësisht të pajisur